



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 5, datë 16.2. 2016

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË BASENIT UJOR”**

Në mbështetje të shkronjës “d”, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kreu II, i vendimit nr.3, datë 19.7.2002, i Këshillit Kombëtar të Ujit, “Për miratimin e rregullore së funksionimit të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshillit të Basenit Ujëmbledhës dhe Agjencisë së Ujit”, të ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
3. Ngarkohen organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

EDI RAMA

MINISTRI


EDMOND PANARITI



RREGULLORE
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË
BASENIT UJOR”

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim vendosjen e rregullave të përgjithshme për organizimin, funksionimin dhe procedurat me anë të cilave Këshilli i Basenit Ujor do të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore.

Neni 2 Fusha e veprimit

Fusha e veprimit të kësaj rregulloreje është tërësia e veprimeve për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor, si dhe marrëdhëniet me institucionet, organet shtetërore, entet publike, subjektet private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e ujit.

Neni 3 Objekti

Objekti i rregullores është organizimi, funksionimi dhe administrimi i veprimtarisë së Këshillit të Basenit Ujor.

Neni 4 Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

1. **“Agjencia”**, Agjencia e Basenit Ujor.
2. **“Akt”**, lloji i vendimit me karakter të përgjithshëm ose individual që merr Këshilli i Basenit Ujor.
3. **“Autorizim”**, akti administrativ, sipas kuptimit të dhënë në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore
4. **“Detyra”**, funksione, detyrime që i ngarkohen Këshillit të Basenit Ujor, nëpërmjet akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave ose Këshilli Kombëtar i Ujit .

5. **“Këshill i Basenit Ujor”**, organi përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në basenin përkatës, në nivel vendor.
6. **“Kompetencë”**, të drejtat që i janë dhënë me ligj, akte nënligjore, apo nëpërmjet delegimit të kompetencave, Këshillit të Basenit Ujor për të vendosur, zgjidhur për një rreth të caktuar çështjesh në fushën e administrimit të burimeve ujore.
7. **“Kërkesë”**, kërkesat e subjekteve publikë dhe privat për dhënie autorizimi ose leje për përdorim burimi ujor.
8. **“Leje”**, akti administrativ, sipas kuptimit të dhënë në ligjin për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.
9. **“Ministria”**, ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore.
10. **“Projektakti”**, projektvendimi me karakter të përgjithshëm ose individual që përgatitet nga agjencia, për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Basenit Ujor.
11. **“Vendim me karakter individual”**, akti nënligjor i Këshillit të Basenit Ujor, i cili rregullon një marrëdhënie konkrete ose u drejtohet një ose disa subjekteve, individualisht të përcaktuara.
12. **“Vendim me karakter normativ”**, akti nënligjor i Këshillit të Basenit Ujor, i cili rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme në basenin përkatës.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 5 Organizimi i Këshillit të Basenit Ujor

1. Qendra, numri, përbërja, mandati dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Basenit Ujor, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.
2. Këshilli i Basenit Ujor kryesohet nga prefekti i qarkut në të cilën ndodhet qendra e Këshillit të Basenit Ujor. Kryetari do të jetë në funksion për atë kohë sa prefekti ushtron detyrën.

3. Këshilli i Basenit Ujor zgjedh nënkryetarin nga anëtarët e tij.

Neni 6 **Kompetencat dhe detyrat**

1. Kompetencat e Këshillit të Basenit Ujor përcaktohen në ligj dhe në aktet nënligjore.
2. Këshilli Basenit Ujor ushtron dhe detyra të tjera të përcaktuara me akte nënligjore.

KREU III **PROPOZIMI I AKTEVE**

Neni 7 **Propozimi i projektaktit**

1. Të drejtën e propozimit të projektaktit, për miratim në mbledhjen e Këshillit, e ka çdo anëtar i Këshillit të Basenit Ujor nëpërmjet Agjencisë si dhe Agjencia.
2. Projektakti shoqërohet me përgatitjen e relacionit shpjegues, raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve buxhetore, si dhe mbi burimet financiare në rastet kur ka efekte financiare.
3. Agjencia i propozon Këshillit të Basenit Ujor, dhënien e lejeve, autorizimeve për përdorimin e burimit ujor kur veprimtaria kryhet brenda kufirit të basenit përkatës sipas kompetencave të përcaktuara në ligj.

Projektaktet, që u përkasin organeve apo institucioneve të tjera shtetërore, qendrore ose lokale, propozohen nëpërmjet kryetarit të Këshillit të Basenit Ujor.

KREU IV **ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I MBLEDHJES**

Neni 8 **Rendi i ditës**

1. Drejtuesi i Agjencisë, në bazë të propozimeve dhe të çështjeve të paraqitura, përgatit rendin e ditës së mbledhjes dhe ia propozon për miratim kryetarit.

2. Rendi i ditës përmban:
 - a) datën dhe orën e caktuar për mbledhjen;
 - b) tematikën që do të trajtohet;
 - c) propozimet dhe kërkesat që do të shqyrtohen ;
 - ç) problemet e ndryshme që do të diskutohen.
3. Kryetari mund ta ndryshojë ose të përfshijë në rendin e ditës dhe çështje të cilat nuk janë propozuara nga drejtuesi i Agjencisë.

Neni 9 **Thirrja e mbledhjes**

1. Kryetari vendos për datën dhe orën e mbledhjes. Mbledhjet thirren si rregull, jo më pak se një herë në 2 (dy) muaj.
2. Agjencia njofton anëtarët e Këshillit të Basenit Ujor, Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe ministrinë, për rendin e ditës, datën dhe orën e mbledhjes së Këshillit të Basenit.
3. Çdo ndryshim në rendin e ditës, datën dhe orën e vendosur për mbledhjet i njoftohet anëtarëve, Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, ministrisë në mënyrë që të njihen me këto ndryshime.
4. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Në këtë rast, Agjencia bën lajmërimin për thirrjen e mbledhjes brenda 15 ditëve pas datës së paraqitjes së kërkesës.
5. Mbledhja e jashtëzakonshme thirret nga kryetari, në pamundësi të tij, thirret nga nënkryetari, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

Neni 10 **Organizimi**

1. Agjencia organizon punën për përgatitjen e mbledhjes së Këshillit të Basenit Ujor.
2. Anëtarëve u vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga subjekti.
3. Anëtarët si rregull, vihen në dijeni për rendin e ditës të shoqëruar me materialin përkatës, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së caktuar për thirrjen e mbledhjes.

4. Për mbledhjet e jashtëzakonshme rendi i ditës dhe materialet shpërndahen jo më vonë se 2 orë përpara orës së caktuar për mbledhje.

Neni 11

Pjesëmarrja

1. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit, një prej të cilëve duhet të jetë kryetari ose nënkryetari.
2. Drejtuesi i Agjencisë merr pjesë rregullisht në mbledhje, pa të drejtë vote.
3. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm më shumë se 50 % e anëtarëve, drejtuesi vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, jo më pak se 48 orë pas të parës. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 12

Kryesimi dhe drejtimi i mbledhjes

1. Mbledhja kryesohet dhe drejtohet nga kryetari.
2. Në mungesë të kryetarit, mbledhja drejtohet nga nënkryetari.
3. Drejtuesi i mbledhjes drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.

Neni 13

Zhvillimi i mbledhjes

1. Mbledhja bëhet me dyer të mbyllura. Në të mund të marrin pjesë përfaqësues të ministrisë dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit.
2. Me propozim të kryetarit, mbledhjet bëhen me dyer të hapura. Në këtë rast Agjencia merr masa për njoftimin e palëve të interesuara. Ky njoftim bëhet të paktën 2 ditë përpara datës së mbledhjes.
3. Për arsye të motivuara, me propozim të kryetarit, për çështje të cilat nuk janë parashikuar në rendin e ditës, Këshilli mund të vendosë mbledhje jashtë radhe për shqyrtimin e tyre.
4. Prezantimi i projektaktit bëhet nga propozuesi. Kërkesat për dhënie autorizimi ose leje të përdorimit të burimit ujor prezantohen nga drejtuesi i Agjencisë.

5. Pas prezantimit, drejtuesi fton anëtarët të japin mendimet e tyre. Vlerësimet, debatet dhe raportimet mbeten kofidenciale.
6. Projektakti mund të tërhiqet nga propozuesi në çdo kohë, deri para votimit të tij.
7. Pas përfundimit të diskutimit drejtuesi fton anëtarët për votim.
8. Drejtuesi i mbledhjes mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përlligj këtë veprim.

Neni 14

Konflikti i interesit

1. Dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore për konfliktin e interesit, zbatohen për të gjithë anëtarët.
2. Anëtarët që kanë ndonjë pengesë ligjore nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe votimit.

Neni 15

Marrja e vendimit

1. Këshilli i Basenit Ujor merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës.
2. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës, përveç rasteve kur me ligj kërkohet një shumicë e cilësuar.
3. Anëtarët që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë.
4. Vendimet merren me votim të hapur.
5. Drejtuesi i mbledhjes voton i fundit.
6. Në rastin kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.
7. Kur rezultati i votimit është i barabartë dhe mbledhja drejtohet nga nënkryetari, vendimi shtyhet në mbledhjen pasardhëse të kryesuar nga kryetari.

Neni 16 Vendimi

Në përfundim të shqyrtimit të projektaktit, Këshilli i Basenit Ujor vendos:

- a) miratimin e projektaktit ose të kërkesës;
- b) miratimin e propozimit me ndryshime;
- c) shtyrjen e vendimit;
- ç) rrëzimin e propozimit
- d) mosmiratimin e kërkesës.

Neni 17 Regjistrimi i mbledhjes

1. Mbledhjet e Këshillit të Basenit Ujor regjistrohen në procesverbal. Procesverbali mbahet nga punojësit e Agjencisë.
2. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
3. Procesverbali nënshkruhet nga punonjësi që e mban, drejtori i Agjencisë dhe drejtuesi i mbledhjes.
4. Në rastet kur mbledhja është e ndarë në seanca dhe drejtuesi e shikon të arsyeshme, procesverbali nënshkruhet pas përfundimit të seancës së fundit.
5. Procesverbali u paraqitet, përpara mbledhjes pasardhëse, anëtarëve të Këshillit të Basenit Ujor, nëse një gjë e tillë kërkohet nga vetë ata. Në këtë rast, anëtarët kanë të drejtë të paraqesin vërejtje për përmbajtjen e tij, kur nuk është pasqyruar saktësisht qëndrimi i tyre në mbledhje.

Neni 18 Hyrja në fuqi e vendimit

1. Vendimet me karakter normativ hyjnë në fuqi pas publikimit me mjetet e informimit publik .
2. Vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi pas zbardhjes së tyre formalisht dhe njohimit të subjektit të interesuar.
3. Lejet apo autorizimet për përdorim të burimit hyjnë në fuqi pas publikimit të tyre në regjistrin e licencave dhe lejeve.

KREU VI
FORMALIZIMI, PUBLIKIMI, NJOFTIMI, ARKIVIMI DHE RUAJTJA
E DOKUMENTACIONIT

Neni 19

Formalizimi, njoftimi, publikimi i vendimeve, lejeve, autorizimeve

1. Vendimi i Këshillit të Basenit Ujor formalizohet nga drejtuesi i Agjencisë dhe nënshkruhet nga drejtuesi i mbledhjes.
2. Formulari i lejes dhe i autorizimit plotësohet brenda 5 ditëve nga data e nënshkrimit të vendimit nga drejtuesi i mbledhjes.
3. Vendimi formalizohet brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të procesverbalit të mbledhjes nga drejtuesi.
4. Vendimet formalizohen në 3 (tri) kopje, nga të cilat një kopje mbahet në arkivën e prefektit, një mbahet në arkivën e Agjencisë dhe një kopje i dërgohet Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit.
5. Agjencia merr masa për njoftimin e institucioneve, organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë që kanë detyrime ose lidhje me përmbajtjen e vendimit.
6. Publikimi i vendimeve bëhet në faqen zyrtare të Agjencisë ose nëpërmjet njoftimeve publike.

Neni 20

Vula dhe protokolli

1. Këshilli i Basenit Ujor ka vulën zyrtare me të cilën identifikohet.
2. Vula ka formën dhe përmban elementet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prodhimin, administrimin, kontrollin dhe ruajtjen e vulave zyrtare. Vula përmban shënimin identifikues "Këshilli i Basenit Ujor".
3. Vula administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo ruhet në kasafortë dhe përdoret vetëm nga punonjësit e ngarkuar me këtë detyrë në rastet e shoqërimit të dokumenteve origjinale, vulosjes së zarfeve etj.
4. Vula vendoset vetëm mbi firmën/nënshkrimin e kryetarit ose nënkryetarit.

5. Në rast të konstatimit të humbjes apo të dëmtimit të vulës, vihet menjëherë në dijeni kryetari dhe drejtori i Agjencisë, ku ky i fundit merr masat për zëvendësimin e saj sipas procedurës ligjore. Përveç sa më sipër, në rastet e humbjes së vulës bëhet dhe denoncimi në organet kompetente.
6. Vula dhe protokollit, administrohet nga punonjësi i protokollit të prefektit, kryetar i Këshillit të Basenit Ujor.

Neni 21

Arkivimi dhe ruajtja e dokumentacionit

Vendimet, pas nënshkrimit të tyre nga drejtuesi i mbledhjes ruhen dhe arkivohen në përputhje me legjislacionin në fushën e arkivave.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Projektaktet e Këshillit të Basenit Ujor, të cilat propozohen për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit paraqiten në emër të Këshillit të Basenit Ujor nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.